

Broshurë teknike

MULTIFILL-DIAMOND 1-12

Stuko pllakash me performancë të lartë, me bazë çimentoje, i modifikuar me polimerë, ideale për dekorime

Përshkrimi

MULTIFILL-DIAMOND 1-12 është një stuko për pllaka me performancë të lartë, për dekorime, izolues i mire ndaj lagështirës, me ngjyra, e cila mund të përgatitet shpejt, i modifikuar me polimerë, me bazë çimentoje. Falë përbërjes së tij pa çimento Portland, ajo siguron një njëtrajtshmëri të përsosur të ngjyrave dhe parandalon shfaqjen e depozitave të kripës dhe të gëlqeres. Për të njëjtën arsye, ajo është gjithashtu edhe e lehtë për t'u përdorur dhe jo irrituese. MULTIFILL-DIAMOND 1-12 zhvillon shumë shpejt, brenda 24 orëve, një fuqi të lartë mekanike. Karakteristika të tjera përfshijnë gjithashtu një rezistencë të shkëlqyeshme ndaj ujit që pikon nga lart. Agjentët e veçantë bakteriostatikë që ajo përmban, parandalojnë rritjen e baktereve në bashkimet (nyjet) e pllakave. Ideale për nyje me përmasa 1-12 mm. I klasifikuar si fino pllakash e tipit CG2 WA në përputhje me EN 13888 & ISO 13007-3. Raporti i testit Nr.: 22/32300791, Laboratorët APPLUS.

Fushat e aplikimit

Ideuar për shtresa të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE dhe MUREVE, në të gjitha llojet e pllakave.

Të dhëna teknike

Forma:	pluhur çimentoz
Ngjyrat:	18
Kërkesa për ujë:	0,90-1,00 l/4 kg për thes
Dendësia e pjesës bazë të llaçit të thatë:	1,20 ± 0,05 kg/l
Dendësia e pjesës bazë të llaçit të freskët:	1,70 ± 0,05 kg/l
Temperatura e aplikimit:	nga +5°C në +35°C
Rezistencë ndaj gërryerjes:	≤ 250 mm ³ (EN 12808-2)
Forca ngjeshëse pas:	
• 28 ditësh:	25,00 N/mm ²
• 25 ciklesh ngrirje-shkrirje:	25,00 N/mm ² (EN 12808-3)

Forca e përkuljes pas:

- 28 ditësh: 7,00 N/mm²
- 25 ciklesh ngrirje-shkrirje: 7,00 N/mm² (EN 12808-3)

Tkurrja për shkak të tharjes: ≤ 1,00 mm/m (EN 12808-4)

Përthithja e ujit pas:

- 30 min: ≤ 0,10 g
 - 240 min: ≤ 0,40 g
- (EN 12808-5)

Jetëgjatësia në kovë: të paktën 50' në +20°C

Qëndrueshmëria

e ecjes mbi tër: pas 3-4 orësh në +20°C

Udhëzimet për përdorim

1. Nënshtrësia

Nënshtrësia e mbuluar nga pllakat duhet të jetë krejtësisht e pastër. Nyjet duhet të pastrohen dhe lagen me një sfungjer të lagur.

2. Aplikimi

MULTIFILL-DIAMOND 1-12 shtohet në ujë duke e përzier vazhdimisht derisa të formohet një pastë e njëtrajtshme. Rekomandohet një mikser me shpejtësi rrotullimi të ulët për përzierjen. Përzierja duhet të lihet të qëndrojë ashtu për rreth 3 minuta dhe pastaj të trazohet përsëri nga pak.

Përhapeni stukon diagonalisht nëpër nyje duke përdorur një shpëhapës gome, në mënyrë që t'i mbushni ato plotësisht. Materiali i tepërt duhet të fshihet pas njëfarë kohe, duke përdorur një sfungjer të lagur, për të shmangur çdo ndryshim të ngjyrës. Në fund, sipërfaqja mund të pastrohet me një leckë të thatë.

Për përdorim në ambiente të jashtme ose në temperatura të larta, rekomandohet lagia e përsëritur pas disa orësh dhe kur stukoja të jetë tharë.

MULTIFILL-DIAMOND 1-12

Konsumi

Konsumi i MULTIFILL-DIAMOND 1-12 varet nga përmasat e pllakave si dhe gjerësia e nyjeve. Rastet e mëposhtme jepen thjesht si referencë (vlerat në g / m²):

Përmasat e pllakve (cm)	Gjerësia e nyjes			
	2mm	4mm	8mm	12mm
2 x 2 x 0.3	820	1.63	---	---
10 x 10 x 0.6	330	650	1.31	1.960
15 x 15 x 0.7	250	510	1.02	1.520
20 x 20 x 0.7	190	380	760	1.140
30 x 30 x 0.8	150	290	580	870
40 x 40 x 0.8	110	220	440	650
50 x 50 x 0.8	90	170	350	520

Paketimi – Ngjyrat

MULTIFILL-DIAMOND 1-12 është në dispozicion në 18 ngjyrat e mëposhtme së bashku me kodet korresponduese, në pako 4 kilogramëshe:

Ngjyra	
01 E bardhë	•
02 E zezë	•
03 Gri	•
05 Gri e lehtë	•
06 Bezhë	•
08 Kafe	•
09 Kafe e lehtë	•
10 Gri e errët	•
17 Anemone	•
20 Gështenjë	•
21 Karamel	•
29 Gri i argjendtë	•
30 Gri çimentoz	•
40 Kafe e errët	•
41 Kafe ngjyrë toke	•
42 Gri në të bezhë	•
45 Ngjyrë rëre	•
46 Gri në të blu	•

Grupe të mostrave realiste të MULTIFILL janë në dispozicion.

Afati i ruajtjes – Kohëzgjatja

24 muaj nga data e prodhimit, në paketim original, të pahapur, në vende të mbrojtura nga lagështia dhe ngricat.

Shënime

- Kur është fjala për pllakat përthithëse prej qeramike dhe guri natyror, rekomandohet të lagni nyjet me ujë të pastër (me ujë pa presion) përpara mbushjes për të parandaluar dehidratimin, i cili mund të shpjerë në reduktim të fortësisë së materialit.
- Duhet pasur kujdes kur procesi i mbushjes kryhet në temperatura të larta, nën rrezet direkte të diellit ose në kushte mjedisore me erë, për të shmangur kështu dehidratimin e llaçit.
- Konsultohuni përpara përdorimit me udhëzimet rreth sigurisë të shënuara në paketim.

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03

Tel. : +30 2310 576 002, Fax: +30 2310 576 029

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu